

Eppc Kosovo kërkon një **Këshilltar/e të Zhvillimit të Biznesit** për një kompani ndërkombëtare me degë në Prishtinë, shumë inovative, cila ofron shërbime online për profesionist dhe biznese të vogla në Kosovë rreth digjitalizimit elektronik, e-commerce, shitjes dhe marketingut.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Viziton bizneset dhe prezanton produktet/ shërbimet e kompanisë;
- Hulumton, mbledh të dhëna rreth bizneseve, dhe zhvillon njohuritë rreth produkteve dhe tregut;
- Monitoron tregun dhe konkurrencën duke mbledhur informata çmimet, produktet, etj;
- Asiston klientët për t'i regjistruar në platformë duke plotësuar informatat e nevojshme;
- Ndërton raportet dhe besueshmërinë me bizneset dhe vendimarrësit;
- Zgjidh ankesat e klientëve duke hetuar problemet;
- Rekomandon ndryshime/ përmirësime në bazë të ndryshimeve në treg;
- Kontribuon përmes punës ekipore për të realizuar rezultatet e planifikuara;
- Përbush nevojat duke arritur 'targetat' mujore/kuartale të shitjes;
- Përgatit raportet dhe jep rekomandimeve për menaxhmentin.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare (përbën avantazh në degët Ekonomi, Biznes, Marketing, ICT);
- Eksperiencë pune së paku pesë (5) vite, dhe minimum dy (2) vite ekperiencë në shitje direkte me biznese (B2B);
- Të jetë person energjik, ambicioz dhe i/e disiplinuar në punë;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, prezantimi dhe shitjeje;
- Paraqitje profesionale dhe i/e orientuar drejt shërbimit ndaj klientit dhe arritjes së objektivave;
- Numër i madh i kontakteve dhe rrjetet e bashkëpunimit me biznese përbën avantazh;
- Të posedojë leje drejtimi, kategoria B.

Të dhënat:

Pozicioni:	Këshilltar i/e Zhvillimit të Biznesit/ Business Development Officer;
Vendndodhja:	Prishtinë;
Pagesa:	Duke filluar nga 800 EUR + përqindje + benefite;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	23.08.2017.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{-it}:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.